



## ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

### Raport nga Takimi i Kolegjjumit të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës

**Për:** Shefat/Zyrtarët Ligjor të Komunave  
**Nga:** Shqipe Arifaj – Zyrtare Ligjor e AKK-së  
**Kopje:** z.Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së  
**Data :** 31 tetor 2011  
**Subjekti :** Raporti i takimit të katërt të Kolegjjumit të Zyrtarëve Ligjor



31 tetor 2011, Restorant “Ujëvarat e Mirushës” Klinë

## **HYRJE**

Asociacioni i Komunave të Kosovës( AKK) organizoi takimin e katërtë të Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës të AKK-së, për vitin 2011.

Qëllimi i takimit mbledhja e zyrtarëve ligjor për të diskutuar për të arriturat e komunave në zbatim të ligjit për partneritetit publiko-privat , nevojat e trajnimit të zyrtarëve ligjor, çështjet aktuale si dhe çështje tjera të cilat janë pjesë e punës së KZL-së.

Në këtë takim morën zyrarët ligjor të Komunave, përfaqësuesi i MAPL-së z.Besim Myrtezani, zyrtarja ligjore e AKK-se znj.Shqipe Arifaj dhe për ta përshëndetur këtë takim nga Komuna e Klinës ishte nënkryetari z.Zenun Zeqa.

## **PËRMBLEDHJE**

Takimin e hapi dhe kryesoi kryesuesi i KZL-së **z.Agim Salihu**, i cili fillimisht i përshëndeti zyrtarët e Komunes së Klinës, për angazhimin e tyre rreth organizimit të këtij takimi në mënyrë të veçantë z.Zenun Zeqën nënkryetari i Komunës së Klinës, i cili erdhi në takim për ta përshëndetur takimin.

**z.Zenun Zeqa**- Në emër të tim dhe në emër të kryetarit të Komunës z.Bashota, e përshëndes Kolegjiutin e Zyrtarëve Ligjor, të cilët e bëjnë një punë mjaft të rëndësishme nëpër komuna. Të gjithë ata që punojnë në komuna e din rëndësinë e zyrave ligjore apo zyrtarëve ligjor, pasi që të gjithë aktet juridike komunale kalojnë nëpër këtë zyre. Unë iu kërkoj falje që smund të qëndroj më gjatë në këtë takim, për shkak të angazhimeve tjera që i kam, juve ju dëshiroj punë të mbarë në këtë takim, dhe shpresojmë sot në Klinë do të kaloni mirë.

Pas fjalës përshëndetëse të z.Zeqa, takimi vazhdoi me rrjedhën e zakonitë , nga z.Salihu i cili më pastaj paraqiti rendin e punës:

1. Shqyrtimi i raportit nga takimi i tretë në Shtërpce
2. Të arriturat e komunave në zbatimin e Ligjit për Partneritet Publiko-Privat ;
3. Nevojat për trajnim të zyrtarëve ligjor
4. Aktuale
6. Të ndryshme.

## **Pika e parë: Shqyrtimi i raportit nga mbledhja e kaluar**

**Kryesuesi – A keni ndonjë vërejtje në raportin nga takimi i kaluar?**

**z.Flamur Vula** – Kam një vërejtje në faqen 4,të raportit ku është diskutimi im dhe i tjerëve lejet e punës duhet të fshihen, jo neni 38.1 .

**U miratua raporti nga takimi i tretë, me vërejtjen e z.Flamur Vula .**

## **Pika e dytë: Të arriturat e komunave në zbatimin e Ligjit për Partneritet Publiko-Privat**

**Kryesuesi** – Për këtë temë do të prezentojë z.Hevzi Matoshi.

**z.Hevzi Matoshi** – Në qershor të vitit 2009 është miratuar Ligji për partneritetet publiko-private dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre nr. 03/L090 datë 25.06.2009 dekretuar me nr. DL-017-2009 datë 5.07.2009 dhe i njëjti ka shfuqizuar Ligjin nr. 02/44, datë 27 prill 2006 për procedurën e dhënies së koncesioneve.Ky ligj i rregullon modalitetet dhe krijon mundësi për kyçjen e sektorit privat në financimin e projekteve infrastrukturore dhe kryerjen e shërbimeve publike.

Poashtu z.Matoshi ndër të tjera, prezantoi për Veçoritë e PPP, Përparësitë dhe përfitimet themelore nga PPP, Modelet e PP dhe aplikimi i tyre në projekte të ndryshme, Modelet themelore të PPP, Koncesioni, Format ose mënyrat për realizimin e PPP, PPP kontraktuese, PPP institucionale (ligji nuk definon saktë), korniza juridike për partneritetin publiko-privat (PPP), Subjektet e PPP, Veprimtaritë sipas PPP, Veprimtaritë sipas PPP, Modelet PPP, identifikimi i projekteve potenciale dhe procedurat për dhënien e koncesioneve dhe ppp, Iniciativa e Sektorit Privat, Përzgjedhja e Partnerit Privat dhe Rrethanat që autorizojnë dhënien e kontratës pa procedurë konkurruese.

**Kryesuesi** – z.Matoshi ka bërë një punë të madhe, sepse e dim që mungojnë aktet nënligjore që e rregullojnë këtë fushë. Në Komunën e Prishtinës, janë dy vendime të kryetarit – ndërtimi i qerdheve dhe ndërtimi i garazheve nëntokësore që do të realizohen me kontrate me partneritet publiko-privat, ndërsa vendimi i tretë për ndarjen e trojeve, ka mbetë e parealizueshme, për arsye të shkurtimit të afatit nga 99 në 40 vite.

**z.Besim Myrtezani (MAPL)** – Tema që keni caktuar është mjaft e qëlluar për arsye se zbatimi i saj në praktikë është shumë i rëndësishëm. Trendet e zhvillimit ku kanë qenë dhe ku po shkojnë- duke parë që kapitali është në sektorin privat, kryetarët duhet të orjentojnë nga sektori privat. Për mes formës së koncensionimit të realizojnë projekte investime kapitale.

**z.Avni Bytyqi**- Ligji për PPP ka tri direktiva përcjellëse. Ne në komunën e Suharekës kemi filluar me këtë proces në fushën e menaxhimit të mbeturinave-mbledhjen e mbeturinave- kemi caktuar grupin punues prej 5 anëtarëve, dhe kemi drejtuar shkresën për Komisionin Ndërmintor për miratim. Sipas direktivës së tretë të Ligjit për PPP- nëse brenda afatit prej 30 ditësh, ky komision nuk e kthen përgjyjen atëherë grupi e konsideron si të miratuar kërkesën dhe vazhdon me procedurat e mëtejshme.

**z.Flamur Vula** – Edhe unë e kam pasur prej kryetarit për detyrë, jam angazhuar mirëpo skam pasur sukses. Në Kosovë skemi përvojë në këtë fushë, p.sh.koncensionimi i aeroportin është përgaditur komplet nga ekspertët anglezë. Nuk kemi kapacitete në Kosovë, nuk kemi pasur as trajnime, kështu që ka zbrazëtira në këtë fushë mjaft shumë.

**z.Isa Hyseni** – Për të realizuar këtë çështje të ppp është problem, sepse ndikojnë edhe ligjet tjera, planet urbane etj. Në Mitrovicë i kemi dy ratse me koncension, ndërtimi i dy banesave.

**z.Faik Gashi** – Ky prentim ishte mjaft i mirëserardhur për komunat, mirëpo për ta zbatuar ligjin në praktikë duhet të mbahet një trajnim, sepse skemi përvojë në këtë fushë.

**znj.Shqipe Arifaj** – Lidhur me këtë çështje që prezantoi z.Matoshi, ne kemi pas organizuar trajnim me Kolegjiunet tjera, ku kanë prezentuar zyrtarët nga Njësia për Partneritet Publiko-Privat në kuadër të Zyres së Kryeministrit, kështu që ne do të organizojmë një trajnim nga kjo fushë, me zyrtarët e Njesisë për PPP edhe me kolegjiunin e juaj.

### **Pika e tretë : Nevojat për trajnim të zyrtarëve ligjor**

**Kryesuesi** – Ne kemi pas paraqitur kërkesat tona edhe më herët për trajnime, mirëpo tani ka ardhur koha të realizohet këto kërkesa. Një trajnim do të jetë me 18 nëntor, për aktet komunale, pastaj trajnimi tjetër do të organizohet nga AKK-ja për partneritet publiko-privat, po ashtu me OSBE-në në regjionin e Pejës do të ketë trajnim për zyrtarët ligjor, që së shpejti do të njoftoheni për datat dhe vendin e mbajtjes së trajnimit.

### **Pika e katërtë: Aktuale**

**Kryesuesi** - Ju informojë se në bashkëpunim me MAPL-në dhe OSBE-në, kemi pasur një punëtor në Tiranë, ku kemi diskutuar për një Udhëzues që do t'ju ndihmojë komunave rreth teknikave të hartimit të akteve nënligjore, pastaj është diskutuar draft- Rregullorja për ligjmerine e akteve komunale nënligjore.

**z. Besim Myrtezani** – MAPL-ja ka përgaditur një doracak- si nxjerr aktet komunale- ju do të keni mundësi të jepni komentet e juaja, po ashtu do të keni edhe trajnim nga kjo fushë.

**Kryesuesi**- Për këtë qështje do të kemi një trajnim në Prishtinë me 18 nëntor 2011- projekt i përbashkët me MAPL-në dhe OSBE-në.

### **Pika e pestë: Të ndryshme**

**Znj.Qerime Koci**- Nëpër komuna secila ministri po dërgon vendime, udhëzime, rregullore, se duhet të formohet kjo zyre, duhet të jenë kaq zyrtarë, pastaj iu caktojnë pagat disa shërbyesve civil, pastaj a janë ligjore këto raste apo jo, shërbyesit civil na drejtohet neve. Pushteti Qendror po ndërhyr në Pushtetin Lokal dhe kjo po na krijon probleme zyrtare ligjore, sepse po duhet me ndryshuar statutin e komunës, pastaj caktimi i koeficientit nga niveli qendror ne nivelin lokal është përzjerje e kompetencave. Kishte me qenë mirë të hartohet një Organogram komunal, që përafërisht të jenë unike pozitat dhe pagat e shërbyesve civil nëpër komuna.

Për çështje të caktimit të pozitave dhe koeficienteve dhe ankesave të shërbyesve civil diskutuan edhe z.Isa Hyseni, z.Agim Sylejmani, ndersa z.Faik Gashi për normativen e rregulloreve komunale.

**Kryesuesi** – Besojme se për qështjen e pozitave të punës dhe koeficientëve duhet të punohet një organogram, i cili do t'ju shërbejë si model të gjitha komunave.

E kemi edhe një kërkesë të z.Bajrush Laqi, i cili ka kërkuar falje për mos marrje pjesë në këtë takim, por ka pasur sot mbledhjen e Kuvendit të Komunës, kështu që unë po paraqes kërkesën e tij. Si duhet bërë pagesë shërbyesve civil të cilët marrin pjesë nëpër komisione të veqanta? Ne në komunën e Prishtinës, pagesën e kryejme me formularë për punë jashtë orarit.

**z.Isa Hyseni** – Me ligjin për mbikqyrjen e financave të pushtetit lokal ndalohet pagesa me kontrate mbi veprën për shërbyesit civil.

**Shërbyesit civil- të cilët janë pjesë e komisioneve të veqanta pagesa e tyre kryhet si punë jashtë orarit.**

**Kryesuesi** – Po e përfundojmë këtë takim, shihemi në trajnimin që do ta kemi në Prishtinë me 18 nëntor 2011- për aktet juridike komunale dhe ligjmerine e tyre.

### **REKOMANDIME**

- Kërkesën për organizim të trajnimit përmes - Njësisë për Partneritet Publiko-Privat në kuadër të Zyres së Kryeministrit;
- Trajnime nga fusha e hartimit të akteve nënligjore-ligjshmëria e tyre –në muajin nëntor-dhjetor, AKK-ja në bashkëpunim me MAPL-në dhe OSBE-në ;
- AKK-ja të caktoj një grup punues për hartimin e organogramit komunal;